

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
X-FRAME CONSTRUCTION
Date 21. 06 . 2021

Sot, më 21 Qershor 2021 i hartua ky statut ne pranine

1. Florenc Hysni Limani , i datelindjes 30.07.1994, lindur ne Burrel dhe banues ne Burrel, i paisur me numer ID J40730003B .

dhe

2. Roland Hysni Limani , i datelindjes 11.01.2000 , lindur ne Burrel dhe banues ne Burrel Tirane, i paisur me numer ID K00111005Q .

Te cilet vendosen të nënshkruajë Statutin, e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, (më poshtë "**Shoqëria**") aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi

Neni. 1 – Emërtimi

Shoqëria do të emërohet me emrin: "**X-FRAME CONSTRUCTION**" ka formen e nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet nga dy ortake. Shoqëria do te filloje te veproje si person juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne Rregjistrin e Shoqerive Tregetare prane QKR Tirane, ndersa veprimtaria ekonomike fillon me regjistrimin ne organet tatimore. Shoqëria do te kete vulen dhe e saj.

Neni. 2 – Selia

Selia e shoqërisë është e vendosur në Rruga Demokracia, objekt privat nr.27, Kamëz, Shqiperi

Neni 3 – Kohëzgjatja

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje për një periudhë 10 VITE duke filluar nga dita e regjistrimit te saj

Neni 4 – Objekti i Shoqërisë

Objekti i veprimtarise te shoqerise "**X-FRAME CONSTRUCTION**" shpk eshte si vijon:

I- Ne Fushen e Ndertimit

*Punime ne fushen e ndertimit si: Produkte alumini dhe xhami , fasada , dyer , dritare , tenda , gyotina . (Cdo gje qe ka lidhje me aluminin dhe xhamin)
Transport mallrash, projektim arkitekture dhe urbanistike, projektim konstruktivi.*

II- Ne fushen e Tregetise

*Tregetim te artikujve te ndryshem (tregeti e pergjitheshme), brenda territorit te Republikes se Shqiperise, sipas Ligjit ne fuqi.
Shtepi private, lokale , restorante , hotele , pallate.*

Asambleja e Ortakeve gezon te drejten te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise sa here ai e ndien te nevojshme

Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma, agjensi dhe ndermarrje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti.

Gjithashtu, per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurise se luajtshme e te paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhenes apo dorezenes, qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.

Neni 5 – Kapitali i shoqërisë

5.1 Kapitali i shoqërisë është 100 leke.

5.2 Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga (një) kuotë tërësisht e nënshkruar, dhe që ka një vlerë nominale sipas kontributeve të ortakëve në kapitalin e shoqërisë.

Neni 6 – Kontributi dhe kuotat

6.1 Kontributi i Kapitalit të shoqërisë do të ndahet sipas mënyrës së mëposhtme:

- Florenc Limani , kuota me vlere te pergjitheshme 50 lek qe perben 1 kuote e barabarte 50 % te kapitalit te shoqerise.
- Roland Limani , kuota me vlere te pergjitheshme 50 lek qe perben 1 kuote e barabarte 50 % te kapitalit te shoqerise.

Neni. 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat mund të transferohen lehtësisht ndërmjet ortakëve.

7.1 Në rastin e heqjes dorë, qoftë me anë pagese apo falas në tërë kuptimin e fjalës, duke përfshirë aty edhe dhurimin e kuotave të shoqërisë subjekteve të ndryshme nga ortakët, kuotat duhet tu ofrohen për parablerje ortakëve të tjerë.

7.2 Në këtë rast ortaku i tjetërsuar duhet t’jua komunikojë me shkrim ortakëve të tjerë me anë të një letre rekomande me kthim përgjigje, vullnetin e tij për shitjen e tyre, duke përcaktuar cmimin, kushtet, modalitetin, emrin e blerësit dhe kushtet e shitjes. E drejta e parablerjes, sidoqoftë, duhet ti referohet kuotës së plotë të ofruar për shitje.

7.3 Ortakët do te kenë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga marrja e letrës rekomande me kthim përgjigje, për t’i paraqitur ortakut të tjetërsuar vullnetin e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes. Me skadimin e afatit të përcaktuar, e drejta e parablerjes në favor të tyre, konsiderohet e mbyllur.

7.4 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ortakut të tjetërsuar do të ndahet midis tyre në proporcion me vlerën nominale të kuotës të kapitalit që sejcili prej tyre zotëron, përveç rasteve kur ka një marrëveshje të ndryshe mes palëve. Në asnjë rast, ofruesi nuk duhet të pranojë ushtrimin pjesor të së drejtës së parablerjes.

7.5 Në rast se mungon ushtrimi i të drejtës së parablerjes, kuotat mund t’i transferohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve, vetëm me miratim të Asamblesë së ortakëve.

7.6 Në rast të transferimit të kuotave trashëgimitarëve per *successione mortis causa*, u lejohej ortakëve të tjerë të shprehin pëlqimin ndaj ortakëve të rinj.

Në rast të mospëlqimit, kuotat mund t'u transferohen tërësisht ose pjesërisht palëve të treta, me miratim të Asamblesë me shumicë të thjeshtë.

Neni 8 – Zmadhim i Kapitalit shoqëror

8.1 Kapitali i shoqërisë mund të rritet pa kufizim në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakut.

8.2 Në rastin e marrjes së vendimit për rritjen e Kapitalit Shoqëror, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë këtë rritje në proporcion me vlerën nominale të kuotave zotëruese të kapitalit.

Në rastin kur nuk mund të ushtrojnë këtë të drejtë kuotat e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë në proporcion me vlerën nominale të kuotës zotëruese të kapitalit.

Neni 9 – Zvogëlim i Kapitalit të Shoqërisë

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë Kapitalin e Shoqërisë vetëm me anë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve. Gjithësesi, Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit mbështetet nga çdo ortak në proporcion me vlerën nominale të kuotës zotëruese të kapitalit.

Neni 10 – Administrimi

10.1 Administrimi i Shoqërisë i besohet 1 (një) Administrator i cili do të jetë:

Roland Hysni Limani i lindur në Burrel, me pashaportë K00111005Q administratori do të ketë kohegjatje në detyrë 1 vit dhe emërohet nga Asambleja me unanimitet.

10.1 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit, duke u mbështetur në nenin 95 të Ligjit n. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të dt. 14 prill 2008 dhe të nenit 14 të Statutit;

10.2 Administratorit i ngarkohen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe detyrat e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit dhe normatives në fuqi. Për këtë arsye, Administratori, mund të kërkojë mbështetjen palëve të treta dhe të konsulentëve të cilëve mund tu delegojë një pjesë ose të tërë kryerjen e aktiviteteve të mësipërme.

10.3 Gjithashtu, Administratori, është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë së themeluar deri në regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratori është i autorizuar të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga momenti i regjistrimit të kompanisë pranë Qendrës së Regjistrimit dhe t'ia delegojë kompetencat e tij ndonjë avokati special.

Neni 11 – Eksperti Kontabël

11.1 Në rastet kur parashikohet nga Ligji, ose vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilancit dhe i librave kontabël të Shoqërisë i besohet një ose më shumë ekspertëve kontabël të autorizuar.

11.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo moment sipas modaliteteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 12 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 12.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë pranë Regjistrimit Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 12.3 Bilancet vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe eventualisht ai i ekspertit kontabël të emëruar, aprovohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji 9901 datë 14.04.2007 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 12.4 Aprovimi i dokumentave lidhur me aktivitetin vjetor, bëhet brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve kalendarike në fund të vitit financiar.

Neni 13 – Fitimi

- 13.1 Fitimet neto që rezultojnë në bilancin vjetor u shpërndahen ortakëve në proporcion me vlerën nominale të kuotës të kapitalit zotëruar.
- 13.2 Asambleja vendos gjithashtu për tërheqje të veçanta të fitimit në favor të rezervave të jashtëzakonshme apo për destinacione të tjera, ose mund të realizojë shtyerjen e shpërndarjes së fitimit tërësisht ose pjesërisht në vitet e ardhshme.

SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 14- Shkrija

- 14.1 Shoqëria shkrihet nëse skadon afati i kohëzgjatjes së parashikuar në Statut ose përpara kësaj skadence në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së ortakëve me shumicë, të parashikuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Shoqëria nuk shkrihet në rast paaftësie, vdekje ose falimentimi të ortakëve.

Neni 15 – Likuidimi

- 15.1 Në rast shkrije, Shoqëria shpallet në likuidim.
- 15.2 Për të menaxhuar këtë procedurë Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa likuidatorë të cilët do të paraqesin raportin final mbi gjëndjen e aktiveve dhe pasiveve të Shoqërisë lidhur me operacionet e likuidimit dhe të kohës së nevojshme për të çuar në fund likuidimin.
- 15.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit Asambleja e Ortakëve do të vendose për bilancin financiar, për vlefshmërinë e punës së kryer nga likuidatori dhe për përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 15.4 Pas shlyerjes së kreditorëve dhe arkëtimit të kredive, likuiduesi/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare nga likuidimi ortakëve në proporcion me vlerën nominale të kuotës zotëruese.


Neni 16 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 16.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin, zgjidhjen e Statutit të kësaj Shoqërie dhe në përgjithësi që mund të lindin ndërmjet partnerëve (me përjashtim të atyre që lidhen me marrëdhëniet personale ose jashtë shoqërisë) ose ndërmjet një ose më shumë ortakëve dhe kompanisë do të kryhen mbi bazën e parimeve miqësore me diskutim të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

16.2 Në rast se palët nuk gjejnë një zgjidhje miqësore atëherë kjo zgjidhje do ti besohet Gjykatës së Tiranës.

ORTAKET

Florenc Hysni Limani



Roland Hysni Limani

